



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA**

**VENDIM**

**Nr. 2, datë 19.01.2018**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME HIMARË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Himarë me:  
Drejtues Ligjor            Andrea Goro  
Drejtues Teknik            Fatjon Beqiraj
2. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Himarë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:  
Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;  
Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura;
3. Zona e shërbimit të kësaj shoqërie është:  
Njësitë Administrative            Himarë dhe Lukovë ( Bashkia Himarë)
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare. Brenda këtij afati kohor shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Himarë duhet të përfshijë në zonën e shërbimit edhe njësinë administrative Horë-Vranisht.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**